



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (d) dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), si dhe nenit 26 pika 4 dhe nenit 56 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, me propozimin e Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.31.01.2024, merr këtë :

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT
PËR VITIN 2024

I.

Aprovohet Plani i punës së Kuvendit të komunës së Deçanit për vitin 2024.

II.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin, Plani i punës së Kuvendit të komunës së Deçanit për vitin 2024.

III.

Kuvendi i Komunës përveç pikave të paraqitura në Planin e punës së Kuvendit të komunës së Deçanit për vitin 2024, gjatë vitit 2024 do të shqyrton edhe çështje të tjera sipas nevojës dhe kërkesës së Ekzekutivit të Komunës.

IV.

Për ekzekutimin e këtij Vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit.

V.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.


VI.

Me Vendim njoftohen: MPL, Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoritë komunale dhe Arkivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr. I-4

Deçan,dt.31.01.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ






PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT PËR VITIN 2024

Në bazë të nenit 40.2 (d) dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe nenit 26 pika 4 dhe nenit 56 të Statutit të Komunës së Deçanit, me propozimin e Kryetarit të komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Deçanit të dt.31.01.2024, miratohet:

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT PËR VITIN 2024

Janar	<ol style="list-style-type: none">1. Shqyrtimi i Raportit një vjeçar të Kryetarit të Komunës.2. Shqyrtimi i raportit analitik financiar për vitin 2023,3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2024,4. Marrja e Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe si dhe mbledhjeve të KPF-së për vitin 2024,5. Marrja e vendimit për ndarjen e parcelave për ndërtimin e tri çerdheve për fëmijë, në fshatin Gramaqel, Isniq dhe Strelle i Epërm.6. Marrja e vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për kontingjentin e tretë me lopë qumështore. Marrëveshja dhe aneks marrëveshja me OZHR "Mëshqerra"7. Ndryshimi dhe Plotësimi i Komitetit të Komuniteteve,	
Shkurt	1.Marrja e vendimit për bartje të hyrave vetanake nga viti paraprak 2023 në vitin aktual fiskal 2024.	



Mars	<ol style="list-style-type: none"> 1. Raport i Komisionit për zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave 	
Prill	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën 01 Janar- 31 Mars 2024. 2. Plani i Trashigimisë Kulturore 3. Plani për menaxhimin e fatkeqësive natyrore. 	
Maj	<ol style="list-style-type: none"> 1. Plani i Veprimit të Këshillit Rinorë 2. Raporti i Komisionit për Emërtimin e Rrugëve, Shesheve, dhe Hapsirave tjera Publike 3. Vizitë studimore në Gjirokaster (Zhvillimi i Agroturizmit) 	
Qershor	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi i draftit të parë të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027, 2. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të jashtëm për NPL “Higjiena”; 3. Shqyrtimi I raportit për barazi gjinore. <p>2. Takimi i I-rë Publik me qytetarë për vitin 2024.</p>	<p>Diskutim publik me qytetarë për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027.</p>
Korrik	<ol style="list-style-type: none"> 1. Raporti gjashtëmuor i Kryetarit të Komunës, 2. Shqyrtimi i raportit gjashtëmuor financiar, 3. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm, 4. Shqyrtimi I raportit gjashtëmuor të Komitetit të Komuniteteve. 	

Gusht	Pushim	
Shtator	<p>1. Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për dy vitet e ardhshme.</p> <p>2.Njoftim I Drejtorisë për Arsim për përgaditjen e vitit shkollor 2024/2025</p>	Diskutim public për Projekt – Buxhetin 2025/2027
Tetor	1.Shqyrtimi i Raportit nëntë mujor financiar,	
Nëntor	1. Caktimi i Normave tatimore për Tatimin në pronë për vitin 2025.	
Dhjetor	<p>1. Takimi i II-të Publik me qytetarë për vitin 2024.</p> <p>2.Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025.</p> <p>3.Shqyrtimi i raportit vjetor të Komitetit të Komuniteteve, Shqyrtimi i raportit të përformancës komunale.</p>	

Kuvendi i Komunës përveç pikave të paraqitura në këtë plan të punës, gjatë vitit 2024 do të shqyrton edhe çështje tjera sipas nevojës dhe kërkesës së Ekzekutivit të Komunës.

01.Nr.I-4

Deçan,dt.31.01.2024

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

